



SHPJEGIM I ANULUESVE TË ISLAMIT

Sherh Navakid el-Islam

ABDULAZIZ RAXH'HI

Shpjegim i anuluesve të Islamit

(*Sherh Neuakidul-Islam*)

Nga Shejkhul-Islam Muhamed Ibn Abdul-Uehab (Allahu e mëshiroftë)

me shpjegim të Shejkh Abdul-Aziz er-Rraxhihi (Allahu e ruajt)

Burimi: Al-Ibaanah.com

Përktheu: Alban M.

Parathënie

Ky libër është përkthimi i ligjëratës të mbajtur nga Shejkh Abdul-Aziz er-Rraxhihi me titull *Sherh Neuakidul-Islam*, në të cilin ai shpjegon risalen e vogël të Muhamed Ibn Abdul-Uehabit "*Neuakidul-Islam*" (**Anuluesit e Islamit**). Komentuesi i kësaj risaleje, Shejkh Rraxhihi, është një nga studentët e afërt të Shejkh Abdul-Aziz bin Bazit, Allahu e mëshiroftë, dhe njëkohësisht një nga dijetarët e mirënjohur të Arabisë Saudite. Ligjërata është marrë e transkriptuar nga **Sahab.net** dhe është përkthyer në anglisht nga Ismail Alarkon për faqen e internetit **al-ibaaanah.com**. Për shkak të dobisë së madhe që përmban kjo vepër, u pa e arsyeshme që të përkthehet edhe në shqip. Padyshim që është tejet e rëndësishme për Muslimanët që të jenë në dijeni për ato gjëra që e bëjnë të pavlefshëm Islamin e tyre, në mënyrë që t'u shmangen dhe të qëndrojnë larg tyre. Në këtë risale të vogël, Imam Muhamed Ibn Abdul-Uehab ka përmendur anuluesit më kuptimplotë, të cilët hasen shpesh herë në jetën e Muslimanit. Autori, Shejkh Rraxhihi, e ka shpjeguar çdo anulues me shembuj të qartë e të prerë. Gjithashtu, në fund është një seksion i veçantë me pyetje dhe përgjigje, që u zhvilluan pas këtij mësimi. Pyetjet janë mjaft të dobishme, pasi ato sqarojnë çështje të tjera të rëndësishme, që lidhen me temën e këtij libri.

Përmbajtja

Anuluesi i Parë

Anuluesi i Dytë

Anuluesi i Tretë

Anuluesi i Katërt

Anuluesi i Pestë

Anuluesi i Gjashtë

Anuluesi i Shtatë

Anuluesi i Tetë

Anuluesi i Nëntë

Anuluesi i Dhjetë

Pyetjet dhe Përgjigjet pas Mësimi

Me Emrin e Allahu të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit

- Anuluesi i Parë

Dije se anuluesit e Islamit janë dhjetë.

I pari: Shirku (të bërit shok) në adhurimin e Allahut. Allahu thotë:

“Vërtet, Allahu nuk fal t’i bëhet shok Atij në adhurim dhe i fal gjynahet e tjera veç kësaj atij që dëshiron Ai.” [Nisa, 116]

Dhe Ai thotë:

“Vërtet, ai që i bën shok Allahut në adhurim, atëherë Xheneti do të jetë haram për të dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarri. Dhe për zullumqarët nuk do të ketë asnjë ndihmues (në Zjarr).” [Ma’ide, 72]

Ajo çfarë hyn tek kjo është prerja kurban për dikë tjetër veç Allahut, për shembull, kur një person pret kurban për një Xhin apo për ndonjë varr.

Shpjegimi

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Zotit të Botëve, dhe salati dhe selami qofshin mbi më fisnikun e Profetëve dhe Pejgamberëve, Profetin tonë Muhamed, mbi Familjen dhe mbi të gjithë Shokët e tij. Në vazhdim:

Këta janë dhjetë Anuluesit e Islamit, të cilët i ka përmendur Imami dhe *Muxhedidi*, Shejkh Muhamed bin Abdil-Uhab, Allahu e mëshiroftë. Ato janë gjëra të cilat e bëjnë të pavlerë Islamin. Ato janë quajtur **“Anulues”**, sepse nëse një person e kryen ndonjë prej tyre, Islami dhe Feja e tij i fshihen dhe nga të qenit Musliman dhe besimtar, ai bëhet prej atyre që bëjnë Shirk dhe adhurojnë idhujt. Allahu na ruajt. Këta Anulues e fshijnë Fenë, Teuhidin dhe Imanin e robit ashtu sikurse anuluesit e Pastërtisë e fshijnë gjendjen e pastërtisë së tij. Kështu që, nëse një person ka marrë abdes dhe është i pastër, pastaj e prish abdesin me anë të urinës, jashtëqitjes, apo gazrave, gjendja e tij e pastërtisë iu anulua dhe është e pavlerë, dhe ai ndodhet në një gjendje papastërtie, pasi që ishte i pastër. I njëjtë është edhe rasti i Muslimanit, besimtarit dhe atij që e pohon Teuhidin (*Muwehidi*) – nëse e kryen ndonjë nga këta Anulues të Islamit, Islami dhe Feja e tij do të anulohen dhe ai do të bëhet idhujtar prej idhujtarëve, pasi që ishte prej Muslimanëve, dhe, nëse vdes në këtë gjendje, ai do të jetë prej banorëve të Zjarrit të Xhehenemit. Nëse ndonjë person e takon Allahun duke pasur këto forma të Shirkut (duke i bërë shok Allahut), Allahu nuk do ta falë atë, sikurse thotë Allahu:

“Vërtet Allahu nuk fal t’i bëhet shok Atij në adhurim dhe i fal gjynahet e tjera veç kësaj atij që dëshiron Ai.” [Nisa, 116]

Shirku bën që të fshihen të gjitha veprat e mira. Allahu thotë:

“Por sikur ata t’i kishin bërë shok Allahut në adhurim, atyre do u ishte fshirë çdo e mirë që kishin punuar” [En-Am, 88];

“Dhe Ne do t’i kthehem asaj që kanë punuar ata dhe do t’ua bëjmë veprat e tyre si pluhuri që fluturon në ajër.” [Furkan, 23]

Xheneti është i ndaluar për atë që bën Shirk, sikurse thotë Allahu:

“Vërtet ai që i bën shok Allahut në adhurim, atëherë Xheneti do të jetë haram për të dhe vendbanimi i tij do të jetë Zjarr. Dhe për zullumqarët nuk do të ketë asnjë ndihmues (në Zjarr).” [Ma’ide, 72]

Në këtë mënyrë, Shirku i fshin të gjitha veprat e robit dhe e nxjerr nga feja Islame atë që e kryen atë. Ai e çon robin drejt Zjarrit të Xhehenemit, që të jetoje aty përgjithmonë, dhe e bën të ndaluar Xhenetin për atë që e takon Allahun me të (me Shirk). Ne i lutemi Allahut që të na ruajë e të na mbrojë. Këta janë Anuluesit. I pari prej tyre është Shirku, bërja shok Allahut në adhurim. Prandaj, kushdo që i bën shok Allahut në njërin nga format e ndryshme të adhurimit, atëherë ai e ka anuluar Islamin dhe Fenë e tij. Shembull për këtë është kur dikush i lutet apo thërret për ndihmë dikë tjetër përveç Allahut ose kur dikush ther kurban për dikë tjetër përveç Allahut.

Ky është shembulli që ka dhënë autori, i cili thotë: **“Ajo ç’ka hyn tek kjo është prerja kurban për dikë tjetër veç Allahut, për shembull, kur një person pret kurban për një Xhin apo për ndonjë varr”**, ose për Pejgamberin, ose për ndonjë nga melekët e kështu me radhë. Shembuj të tjerë janë, për shembull, kur dikush bën një zotim tek dikush tjetër veç Allahut, ose i përkulet dhe i bën sexhde dikujt tjetër veç Allahut, ose kur dikush bën *tauaf* rreth diçkaje tjetër veç Shtëpisë së Allahut (Qabes), duke kërkuar me këtë afrim tek Allahu, apo çfarëdo lloj forme tjetër të Shirkut. Kështu që, nëse dikush nga krijesat bën shirk në adhurimin e Allahut, Islami dhe Feja e tij anulohen. Ky është Anuluesi i parë. I lutemi Allahut të na ruajë e të na mbrojë nga ai.

- Anuluesi i Dytë

I dyti: Kushdo që vendos ndërmjetësues mes tij dhe Allahut, u lutet atyre, kërkon ndërmjetësim prej tyre dhe kërkon mbështetjen e tyre, ka bërë kufër (mosbesim) sipas *Ixhmasë* (mendimit të përbashkët të krejt Ulemave).

Shpjegimi

Anuluesi i Dytë është një formë e Shirkut. Shirk është një term i përgjithshëm, por kjo vepër është më specifike, dhe prandaj autori e ka përmendur këtu, edhe pse kjo bie nën

kuptimin e Anuluesit të Parë. Sidoqoftë, ky është specifik, si për shembull, kur një person vendos ndërmjetësimin e Muhamedit mes tij dhe Allahut dhe i lutet atij duke i thënë: “O Muhamed më ndihmo!” ose “O Muhamed ndërmjetëso për mua para Zotit tim!”. Pra ai e ka vendosur Muhamedin (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*) si ndërmjetësues mes tij dhe Allahut. Ose ai vendos ndonjë nga melekët ose ndonjë *ueli*, ose ndonjë xhin apo varr (si ndërmjetësues), ose i lutet diellit apo hënës, duke i bërë në këtë mënyrë ndërmjetësues mes vetes dhe Allahut. Kështu që ai u lutet atyre, derisa ata bëhen ndërmjetësues mes vetes së tij dhe Allahut, ose pret kurban për ta, ose zotohet për ta, ose u lutet atyre, në mënyrë që të ketë një ndërmjetësues mes tij dhe Allahut. Por, gjatë gjithë kësaj, ai pretendon se kjo e sjell atë më afër Allahut, siç thotë Allahu:

“Dhe ata që marrin ndihmues të tjerë veç Allahut thonë: 'Ne nuk i adhurojmë ata veçse që të na afrojnë tek Allahu.'” [Zumer, 3]

Por, Allahu i ka shpallur ata mosbesimtarë dhe gënjeshtarë, për shkak të thënies së tyre.

“Vërtet, Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë që patën mosmarrëveshje. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar mohues.” [Zumer, 3]

Pra, ata janë mosbesimtarë, për shkak të thënies së tyre dhe ata janë mosbesimtarë, për shkak të veprimit të tyre.

Allahu thotë:

“Dhe ata adhurojnë në vend të Allahut atë që as nuk i dëmton e as nuk u bën dobi, dhe thonë: 'Këta janë ndërmjetësit tanë para Allahut.'” [Junus, 18]

Pra, kushdo që vendos ndërmjetësues mes tij dhe Allahut, u lutet apo ther kurban për ta, apo zotohet dhe kërkon mbështetje prej tyre, atëherë ai është vërtet mosbesimtar, sipas *Ixhmasë* (mendimit të përbashkët) të Muslimanëve. I lutemi Allahut të na ruajë e të na mbrojë.

- Anuluesi i Tretë

I treti: Kushdo që nuk i konsideron mushrikët mosbesimtarë, ose ka dyshime për kufrin, mosbesimin e tyre, ose i konsideron të sakta rrugët dhe besimet e tyre, ka mohuar (ka bërë kufër).

Shpjegimi

Kuptimi i këtij Anuluesi është: që dikush të mos besojë se mushrikët janë në mosbesim (në kufër). Termi “mushrikët” është i përgjithshëm dhe përfshin të gjithë llojet e mosbesimtarëve. Prandaj, çdo mosbesimtar është mushrik, dhe, kushdo që nuk e konsideron mosbesimtarin si të tillë, atëherë ai vetë është mosbesimtar, ashtu sikurse ai.

Kushdo që nuk i konsideron Çifutët, të Krishterët, Mexhusitë, adhuruesit e idhujve, munafikët apo Komunistët mosbesimtarë, atëherë ai vetë është mosbesimtar. E njëjta gjë thuhet edhe për atë që ka dyshim për mosbesimin e tyre, si, për shembull, ai që thotë: “Nuk jam i sigurt. Ka të mundur që Çifutët të jenë tek e vërteta.” Ose mund të thotë: “Nuk ka problem që njerëzit të praktikojnë besimin çifutë, besimin e krishterë apo besimin Islam, ato janë të gjitha besime hyjnore”, siç bëjnë disa njerëz sot, të cilët thërrasin për unifikimin e këtyre tri feve. Kushdo që mban këtë besim, është qafir, mosbesimtar. Robi duhet të besojë se Çifutët janë mosbesimtarë dhe janë në një fe të rreme, dhe duhet të distancohet nga ata dhe nga feja e tyre, dhe t’i armiqësojë për hir të Allahut. E njëjta gjë është edhe me të Krishterët: robi duhet t’i konsiderojë ata mosbesimtarë. Dhe e njëjta gjë është edhe me adhuruesit e idhujve, Mexhusitë dhe të gjithë mosbesimtarët të tipave të ndryshëm.

Po ashtu, robi bën kufër, nëse dyshon se a janë ose jo mosbesimtarë, si, për shembull, kur dikush thotë: “Nuk e di, nëse Çifutët janë ose jo mosbesimtarë. Ata mund të jenë tek e vërteta.” Ky person ka bërë kufër (ka mohuar). Robi duhet të ketë vendosmëri dhe mendim të palëkundur se ata janë mosbesimtarë.

E ngjashme me këtë është ajo, kur robi i konsideron rrugët dhe besimet e tyre të sakta, për shembull, kur thotë: “Ata janë në një fe të saktë” ose “në një fe të vërtetë”. Personi që e thotë këtë, bëhet mosbesimtar si ata, për arsye se, ai që nuk i konsideron mushrikët mosbesimtarë, nuk i ka mohuar *Tagutët*. Dhe nuk ka Teuhid, përveç se me dy gjëra:

(1)- Besimin në Allahun dhe (2)- Mohimin e *Tagutit*.

Kështu që, ai i cili nuk i konsideron mosbesimtarë mushrikët, Çifutët dhe të Krishterët, ai nuk i ka refuzuar *Tagutët* (ata që adhurohen në vend të Allahut), dhe Teuhidi i tij është i pavlerë dhe ai nuk ka Iman. Prandaj, dy gjëra kërkohen për Teuhidin: (1)- Refuzimi i *Tagutit* dhe (2)- Besimi në Allahun. Kjo gjendet në shprehjen e Teuhidit: ***La ilahe il-lallah*** (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut). ***La ilahe*** (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë): ky është Refuzimi i *Tagutit*. ***Il-lallah*** (përveç Allahut): ky është besimi në Allahun. Dhe kjo, sepse dëshmia ***La ilahe il-lallah*** i mohon të gjitha format e adhurimit, që bëhen për dikë tjetër në vend të Allahut.

Mohimi i *Tagutit* do të thotë të refuzosh dhe të mohosh adhurimin që kryhet për dikë tjetër veç Allahut, distancimi prej tij dhe prej njerëzve të tij, si dhe armiqësimi i tyre. Këtë kuptim ka Mohimi i *Tagutit*. Pra, kërkohet armiqësimi i mushrikëve dhe urrejtja e tyre për hir të Allahut. Allahu thotë për Ibrahimin:

“Në të vërtetë, ju keni shembullin më të mirë tek Ibrahimimi dhe ata që ishin me të, kur ata i thanë popullit të tyre: 'Vërtet, ne jemi të pastër nga ju dhe çfarëdo që adhuroni në vend të Allahut. Ne ju kemi refuzuar dhe mes nesh ka armiqësi dhe urrejtje të hapur, derisa ju të besoni Allahun të vetëm.'” [Mumtehine, 4]

Kjo është *Hanifija* (Feja e Drejtë), feja e Ibrahimit, që ta adhurosh Allahun me sinqeritet, duke e bërë fenë vetëm për Të dhe të qëndrosh larg nga adhurimi i çdo gjëje tjetër përveç Allahut, duke e mohuar dhe refuzuar atë (që adhurohet në vend të Allahut), ndërkohë që i urren dhe i armiqëson njerëzit e tij (njerëzit e *Tagutit*).

- Anuluesi i Katërt

I katërti: Kushdo që beson se udhëzimi i ndonjë tjetri veç Muhamedit (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*) është më i përsosur, sesa udhëzimi i tij dhe se gjykimi i ndonjë tjetri është më i mirë, sesa gjykimi i tij, si, për shembull, ai që parapëlqen gjykimin e *Tagutëve* para gjykit të tij, atëherë ky është qafir, mosbesimtar.

Shpjegimi

Kushdo që beson se ka udhëzim më të mirë se udhëzimi i Profetit (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*), duke thënë, për shembull: “Rruga e filozofëve, Sabianëve¹ dhe Sufive është më e mirë, sesa rruga e Muhamedit” ose “Nuk ka udhëzim në këtë rrugë” ose “Kjo është sikurse udhëzimi i Profetit”. Personi që e thotë këtë, është mosbesimtar, për arsye se nuk ka udhëzim që të jetë më i mirë, sesa udhëzimi i Pejgamberit, sepse ai nuk flet nga qejfi i vet, porse ajo është shpallje që i është zbritur atij. Pra, kushdo që thotë se ka një udhëzim më të mirë, sesa udhëzimi i Pejgamberit të Allahut, apo i ngjashëm me të, për shembull, kur ai praktikon apo kërkon një rrugë për tek Allahu me anë të rrugës së filozofëve, Sabianëve apo Sufive, atëherë ky person është mosbesimtar, ka dalë nga feja (*murted*). Po ashtu, kur dikush beson se ka një gjykim më të mirë, sesa gjykimi i Profetit, për shembull, kur dikush beson se të gjykos me ligjet e bëra nga njeriu është më mirë se të gjykos me Sheriat, ky person ka dalë nga feja sipas mendimit të përbashkët të krejt Muslimanëve. E njëjta gjë edhe për atë që beson se të gjykos me ligjet e bëra nga njeriu është njësoj si të gjykos me Sheriat. Ky, po ashtu, ka bërë kufër. Po ashtu, nëse ai beson se gjykimi me Sheriat është më i mirë, sesa gjykimi me ligjet e bëra nga njerëzit, por, megjithatë, është e lejuar të gjykos me ligjet e bëra nga njerëzit, për shembull, kur ai thotë: “Njerëzit janë të lirë që të zgjedhin, lejohet që robi të gjykojë me ligjet e bëra nga njerëzit dhe lejohet që ai të gjykojë me Sheriat, por, sidoqoftë Sheriati, është më i mirë”, atëherë ky person ka bërë kufër, sipas *Ixhmasë* së Muslimanëve. Njerëzit nuk kanë liri të zgjedhuri në këtë çështje. Dhe ky person ka refuzuar diçka që njihet tek kjo Fe si e domosdoshme.

1. Sabianët kanë qenë një popull që kanë jetuar në Mosul të Irakut, të cilët lexonin Zeburin dhe thoshin *La ilahe il-Allah*, porse nuk ishin as Çifutë e as të Krishterë.

Pra, gjykimi me Sheriat është një obligim për çdo njeri. Ndërsa ky njeri thotë: “Kjo nuk është obligim, lejohet për njerëzit që të gjykojnë me ligjet që kanë bërë njerëzit.” Personi i

tillë është mosbesimtar, edhe nëse ai thotë: “Ligjet e Sheriatit janë më të mira.” Kështu që, duke u bazuar mbi këtë, nëse dikush gjykon me ligjet e bëra nga njerëzit dhe beson se ato janë më të mira, sesa gjykimi me Sheriat, ai ka mohuar, ka bërë kufër. Dhe, nëse ai gjykon me ligjet e bëra nga njerëzit dhe beson se ato janë të barabarta me gjykimin me Sheriat, ai ka mohuar, ka bërë kufër. Dhe, nëse ai gjykon me ligjet e bëra nga njerëzit, por ndërkohë beson se të gjykuarit me Sheriat është më i mirë, sesa gjykimi me ligjet e bëra nga njerëzit, por, megjithatë, lejohet të gjykohet me ligjet e bëra nga njerëzit, ai përsëri ka mohuar, ka bërë kufër. Pra, në të tre rastet, ky person ka bërë kufër.

Ka dhe një rast të katërt, i cili është atëherë kur dikush gjykon me ligjet e bëra nga njerëzit ose gjykon me një prej tyre në një çështje ose në një çështje juridike, por ndërkohë ai beson se gjykimi me Sheriat është obligim dhe se nuk lejohet të gjykos me ligjet e bëra nga njerëzit dhe se nuk lejohet të gjykos me diçka tjetër veç asaj që e ka shpallur Allahu, dhe se ai beson se po vepron gabim dhe meriton të dënohet. Megjithatë, epshet dhe dëshirat e tij të brendshme dhe shejtani e kanë mposhtur, kështu që ai gjykon me diçka tjetër veç asaj që e ka shpallur Allahu. Ai gjykon mbi një person me diçka tjetër veç asaj që e ka shpallur Allahu, në mënyrë që t’i bëjë dobi personit që po e gjykon ose ta dëmtojë atë. Pra, ai i bën dobi atij që po e gjykon, për shkak se ai është miku i tij, i afërm apo komshiu i tij. Ose ai po e dëmton atë që po e gjykon, sepse ai është armiku i tij, por ndërkohë ai e di se gjykimi me atë që ka shpallur Allahu, është obligim dhe po bën gjynah. Personi i tillë ka bërë kufër të vogël dhe ai nuk ka dalë nga Islami.

Prandaj, gjykimi me diçka tjetër veç asaj që ka shpallur Allahu ndodh në katër situata. Tre nga këto situata rezultojnë që robi të bëjë kufër të madh, dhe e katërta rezulton që robi të bëjë kufër të vogël.

Çështje: Gjykimi i heqjes së Sheriatit në tërësi dhe Gjykimi me ligjet e bëra nga njerëzit

Nëse një person vendos të gjitha ligjet e bëra nga njerëzit dhe e heq të gjithë Sheriatin, duke e zëvendësuar atë tërësisht, kjo konsiderohet ndryshim i Fesë. Një grup mes dijetarëve mbajnë këtë mendim, se personi që e bën këtë ka mohuar, sepse ai ka ndryshuar Fenë e Allahut. Kjo është fetvaja që ka dhënë Shejkh Muhamed bin Ibrahim, Allahu pastë mëshirë për të, ish Muftiu i tokave të Arabisë Saudite (para Shejkh Bin Bazit, Allahu e mëshiroftë, sh.p.). Ai ka thënë: “Ky është ndryshim i Fesë plotësisht. Kjo nuk është vetëm në një çështje, porse kjo është ndryshim i të gjitha ligjeve. Prandaj, kjo do të thotë heqje e Sheriatit në tërësi dhe zëvendësim i tij me ligjet e bëra nga njerëzit në çdo çështje, të madhe apo të vogël.” Përveç kësaj, mësuesi ynë, Shejkh Abdul-Aziz bin Baz, Allahu e mëshiroftë, ishte i mendimit se, edhe po qe se ai e ndryshon Fenë (në aspektin juridik), ai duhet të besojë se është e lejuar të gjykohet me ligjet e bëra nga njerëzit, në mënyrë që të ngrihet argumenti kundër tij. Pra, ky është rasti i pestë, kur dikush e ndryshon Fenë.

Është, gjithashtu, edhe një rast i gjashtë, i cili është atëherë kur gjykatësi mundohet dhe përpiqet të arrijë dijen për një gjykim fetar, por ai gabon dhe gjykon me diçka tjetër veç asaj që ka shpallur Allahu. Kjo është gabim. Pra, ky person nuk është mosbesimtar dhe as gjynahqar, porse ai është *Muxhtehid* i cili ka një shpërblim, duke u bazuar në thënien e Profetit: **“Kur gjykatësi jep një vendim duke bërë *Ixhtihad* dhe është i saktë, ai merr dy shpërblime; nëse bën *Ixhtihad* dhe gabon, ai merr një shpërblim.”**

Pra, gabimi i tij është i falur dhe ai merr një shpërblim për *Ixhtihadin* e tij. Dhe, nëse ai përpiqet me mundësitë që ka dhe e arrin të vërtetën, atëherë merr dy shpërblime – një shpërblim për *Ixhtihadin* (mundin e tij) dhe një shpërblim për arritjen e të vërtetës.

- Anuluesi i Pestë

I pesti: Kushdo që urren diçka me të cilën erdhi Pejgamberi, edhe nëse punon në përputhje me të, ai ka mohuar.

Shpjegimi

Për shembull: kjo ndodh atëherë kur dikush e urren namazin. Pra, ai ka mohuar, edhe nëse mund të jetë prej atyre që falen. Ose, për shembull, kur ai nuk e pëlqen atë. Argument për këtë është fjala e Allahut:

“Kjo, për shkak se ata e urryen atë që ka zbritur Allahu, kështu që Ai i bëri të pavlefshme veprat e tyre.” [Muhamed, 9]

Pra, nëse ai e urren diçka që e ka sjellë Pejgamberi (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*), si, për shembull, diçka nga çështjet e obliguara ose diçka nga shpërblimi apo dënimi, ose kur urren që të zbatohen ligjet ndëshkimore mbi zinaqarin apo hajdutin, ose nuk i pëlqen ato, atëherë ky person ka mohuar, ka bërë kufër, për shkak se ai e ka urryer apo nuk ka e pëlqyer atë që e ka shpallur Allahu.

- Anuluesi i Gjashtë

I gjashti: Kushdo që përqesh apo tallet me ndonjë pjesë të Fesë së Pejgamberit ose me shpërblimet apo dënimet e saj, ka bërë një vepër kufri. Argument për këtë është fjala e Allahut:

“Thuaju: A me Allahun, me Ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleni? Mos u shfajësoni, ju keni mohuar, pasi që besuat.” [Teube, 65-66]

Shpjegimi

Ky është si rasti i atij që tallet me Namazin, me Zekatin ose me ata që falen, duke i përqeshur, sepse ata nuk falen, për shkak të personalitetit të tyre. Ose tallet dhe i përqesh ata që kryejnë Haxhin. Ose i tall ata që bëjnë *tavaf*, për shkak se ata nuk e bëjnë këtë personalisht për vetët e tyre. Ose tallet me shpërblimet e Xhenetit, si, për shembull, kur i thuhet atij se *Muwehidi* (ai që pohon Teuhidin) do të hyjë në Xhenet dhe aty ka këtë e këtë kënaqësi, ai tallet dhe e i përqesh këto, ose tallet me Zjarrin e Xhehenemit. Ky person ka bërë kufër, duke u bazuar mbi thënien e Allahut:

“Thuaju: A me Allahun, me Ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleni? Mos u shfajësoni, ju keni mohuar, pasi që besuat.” [Teube, 65-66]

Ky ajet u shpall për një grup njerëzish që u tallën dhe përqeshën Profetin gjatë ekspeditës për në luftën e Tebukut. Ata thanë: “Nuk kemi parë njerëz më të babëzitur për të mbushur barqet e tyre, më gënjeshtarë me gjuhët e tyre dhe më frikacakë në fushëbetejë sesa këta shokët tanë.” Ata e kishin fjalën për Pejgamberin dhe për Sahabët. Kështu që ky ajet u shpall për ta.

Po ashtu, nëse dikush shan Pejgamberin ose Islamin, ai ka bërë kufër.

- Anuluesi i Shtatë

I shtati: Magjia, e cila përfshin formula magjike që e bëjnë një njeri ta urrejë diçka që e kërkon (*sarf*) ose të dojë diçka të cilën ai nuk e kërkon (*’atf*). Dhe, kushdo që e kryen atë apo është i kënaqur që të kryhet ajo, ai ka bërë kufër. Argument për këtë është fjala e Allahut:

“Por asnjëri prej këtyre dyve (dy melekët, Haruti dhe Maruti) nuk ia mësuan diku (magjinë), derisa t’u kenë thënë më përpara: Vërtet, ne jemi një sprovë, kështu që mos mohoni.” [Bekare, 102]

Kjo, për arsye se magjistari, magjia e të cilit realizohet nëpërmjet shejtanëve, pa kurrfarë dyshimi duhet të zbatojë disa akte të Shirkut drejtuar Xhinit Shejtan, në mënyrë që Xhini ta ndihmojë atë. Kështu që shërbimi karshi njëri-tjetrit bëhet reciprok mes Xhinit dhe njeriut magjistari, dhe ka një lidhje mes këtyre të dyve. Xhini nuk i shërben magjistarit, derisa ai t’i bëjë Allahut Shirk, kështu që ai bën disa forma të Shirkut, si, për shembull, kur i lutet atij (Xhinit), në vend të Allahut, dhe ther kurban për të. Ose shejtani mund ta urdhërojë atë që të shkeli mbi *Mus’haf* (mbi Kur'an) me këmbët e tij, ose të urinojë mbi të, ose ta ndyjë me fëlliqësira. Kështu që, kur magjistari bën kufër, shejtani i shërben atij, duke e informuar për disa çështje të fshehta, ose vjedh ndonjë gjë për të, ose i përgjigjet atij, kur ky e urdhëron që të godasë ndonjë njeri e shumë të tjera. Pra, kushdo që bën

magji apo është i kënaqur me të, ka bërë kufër, sepse ai që është i kënaqur me të është njësoj si ai që e bën atë. Allahu thotë:

“Por asnjëri prej këtyre dyve (dy melekët, Haruti dhe Maruti) nuk ia mësuan dikujt (magjinë) derisa t’u kenë thënë më përpara: Vërtet, ne jemi një sprovë; kështu që mos mohoni.” [Bekare, 102]

Ky është lloji i magjisë për të cilën ai që e bën atë, mban kontakt me shejtanët. Kurse, sa për atë lloj magjie, të cilën ai që e praktikon nuk mban kontakt me shejtanët, siç është magjistari që nuk kontakton me shejtanët, por u jep njerëzve ca ilaçe dhe pije dehëse, dhe u jep atyre lëngje që i dëmtojnë ata, duke u marrë lekët në mënyrë të padrejtë, ky person, nëse e konsideron këtë gjë të lejuar, ka bërë kufër.

Dhe, nëse ai e konsideron të lejuar marrjen e pasurisë së njerëzve padrejtësisht dhe dëmtimin e tyre, atëherë ai ka bërë kufër. Por, nëse nuk i konsideron të lejuara, atëherë ai ka bërë një nga gjynahet e mëdha, sepse ai nuk ka mbajtur kontakt me shejtanët. Por, sa për magjistarin që mban kontakt me shejtanët, atëherë ai ka bërë një vepër kufri, sepse (në këtë rast) magjistari do të vazhdojë të bëjë kufër.

- Anuluesi i Tetë

I teti: Përkrahja dhe ndihmesa e mushrikëve kundër Muslimanëve. Argument për këtë është fjala e Allahut:

“Cilido prej jush që do t’i marrë ata si përkrahës, atëherë ai sigurisht është prej tyre. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon keqbërësit.” [Maide, 51]

Shpjegimi

Nëse dikush i ndihmon mushrikët kundër Muslimanëve, kjo do të thotë se ai është miqësuar me mushrikët dhe i do ata. Kështu që miqësimi i tij me ta është dalje nga feja sepse kjo tregon dashurinë që ka ai për ta. Nëse ai i ndihmon mushrikët kundër Muslimanëve me lekë, me armë ose duke u dhënë mendim, ky është argumenti që ai i do ata, dhe t’i duash ata është braktisje e fesë. Pra, t’i duash ata është themeli për kërkimin e miqësisë me ta. Dhe ajo çfarë buron prej kësaj, është përkrahja dhe ndihma për mushrikët kundër Muslimanëve, e kjo do të thotë se ai ka parapëlqyer Mushrikët para Muslimanëve. Por, nëse ai e ndihmon një mushrik kundër një mushriku tjetër, atëherë kjo është një çështje e cila nuk hyn tek ky diskutim.

- Anuluesi i Nëntë

I nënti: Kushdo që beson se është e lejuar për disa persona që të jenë të lirë nga zbatimi i Sheriatit të Muhamedit, ashtu sikurse Khidri ishte i lirë nga Sheriati i Musait, atëherë ky është mosbesimtar.

Shpjegimi

Kjo do të thotë se ai beson se është e lejuar për të që të jetë i lirë nga zbatimi i Sheriatit të Muhamedit dhe se ai mund ta adhurojë Allahun me diçka tjetër veç Sheriatit me të cilin erdhi ai, dhe ai beson se do ta arrijë Allahun dhe do të jetë prej banorëve të Xhenetit, edhe në qoftë se nuk i nënshtrohet Sheriatit të Muhamedit, sikurse kanë thënë disa nga filozofët. Pra, ai e adhuron Allahun nëpërmjet rrugës së filozofisë, ose Sabianizmit, ose rrugës së Sufizmit, duke menduar se mund të arrijë tek Allahu me anë të rrugës së Muhamedit ose me anë të rrugëve të tjera, dhe thotë: “Ato janë që të gjitha njësoj.” Ky person është mosbesimtar, sepse nuk ka rrugë me të cilën dikush mund të shkojë drejt Allahut, përveç rrugës së Pejgamberit (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*). Askush nuk është i lirë që të mos e zbatojë Sheriatin e Profetit, sepse ai është gjithëpërfshirës, si për Xhinët, ashtu edhe për njerëzit, dhe ai është Sheriati i fundit nga të gjithë Sheriatet e tjerë (që u shpallën për Profetët e mëparshëm). Sa për Khidrin, i cili ishte i lirë nga Sheriati i Musait, atëherë ky nuk është argument, sepse Sheriati i Musait nuk ishte gjithëpërfshirës si ai i Muhamedit (sepse sheriatit i Musait ishte vetëm për Bijtë e Izraelit). Dhe, gjithashtu, Khidri ishte vetë Profet të cilit i zbriste shpallja, sipas mendimit më të saktë (të dijetarëve). Por, nëse do të merrnim mendimin tjetër, i cili është ai që thotë se ai nuk ishte profet, atëherë ai, po ashtu, nuk ishte nga Bijtë e Izraelit dhe Musai nuk ishte dërguar pejgamber për të. Ai ishte dërguar vetëm për Bijtë e Izraelit. Prandaj, përderisa Khidri nuk ishte prej tyre, Sheriati i Musait nuk mund të zbatohej mbi të. Megjithatë, mendimi më i saktë është se ai ishte Profet dhe atij i zbriste shpallja, dhe kjo është arsyeja përse Musai shkoi për të mësuar tek ai. Allahu ka thënë (duke cituar Khidrin):

“Dhe nuk i bëra këto gjëra nga urdhri im.” [Kehf, 82]

Ky është argument se ai ishte profet që kishte shpallje që i shpallej atij. Do të ishte e pamundur për të që të vriste djalë, ose ti vinte flakën anijes, ose ta rindërtonte murin për shkak të frymëzimit të tij, nuk do të ishte e mundur për të që t'i bënte të gjitha këto, përveç se nëpërmjet shpalljes.

(Sh.p: Historia e Musait që takohet me Khidrin gjendet në Kur'an në suren Kehf, ajetet 60-82, dhe poashtu shiko Sahihul-Bukhari, përK.Ang: vol. 6, n. 249)

Duke e përmbledhur atë çfarë u tha: kushdo që beson se është e lejuar për dikë që të jetë i lirë nga Sheriati i Muhamedit, ashtu sikurse ishte e lejuar për Khidrin që të ishte i lirë nga Sheriati i Musait, atëherë ai është mosbesimtar, për shkak se Sheriati i Muhamedit, i cili u dërgua për të gjithë, ndryshon nga Sheriati i Musait, i cili u dërgua në mënyrë të veçantë për Bijtë e Izraelit. Pra, është e lejuar për dikë që nuk është nga Bijtë e Izraelit të

jetë i lirë nga Sheriati i Musait. Kurse, sa për Sheriatin e Muhamedit, nuk është e lejuar për askënd që të jetë i lirë prej tij.

- Anuluesi i Dhjetë

I dhjeti: Largimi nga Feja e Allahut duke mos e mësuar apo duke mos e zbatuar atë (është një vepër kufri). Argument për këtë është fjala e Allahut:

“Dhe kush bën padrejtësi më të madhe se ai të cilit i kujtohen Ajetet e Zotit të tij dhe pastaj ua kthen shpinën atyre? Vërtet, Ne do t'u hakmerremi kriminelëve.” [Sexhde, 22]

Nuk ka ndonjë dallim në lidhje me (kryerjen e ndonjërit nga) këta anulues, midis atij që bën shaka, atij që është serioz dhe atij që bën kështu nga frika. Megjithatë, ai që i kryen ato, për shkak të imponimit apo detyrimit me forcë, është i justifikuar. Të gjitha këto (dhjetë) çështje përmbajnë rrezikun më të madh dhe ndodhin shumë shpesh, kështu që Muslimanit i duhet të ketë kujdes dhe të frikësohet se mos këto veprime i bien atij. Allahu na ruajt nga këto gjëra të cilat sjellin Zemërimin e Tij dhe Ndëshkimin e dhimbshëm. Salati dhe selami qofshin për më të mirin e krijesave të Tij, Muhamedin (*salallahu alejhi ue sel-lem*).

Shpjegimi

Autori thotë se nuk ka ndonjë dallim në lidhje me këto dhjetë anulues, midis atij që i bën qëllimisht, ose duke bërë shaka, ose nga frika – ky person ka bërë kufër. Për shembull, dikush kryen një nga këto aktet dhe pastaj thotë: “Bëja shaka”, ai përsëri bën kufër për shkak të saj, edhe nëse ai ishte veç duke luajtur. Ose ai mund ta bëjë qëllimisht ose seriozisht, e në rast të tillë ai ka bërë kufër. Ose ai mund ta bëjë nga frika, dhe këtë rast ai, gjithashtu, ka bërë kufër. Askush nuk është i justifikuar, përveç atij që është imponuar apo detyruar me forcë, dhe bëhet fjalë që detyrimi i tij është jetik, si, për shembull, kur dikush i vë shpatën në fyt e i thotë: “Moho, sepse përndryshe të vramë.” Ky person (i detyruar) nuk bën kufër, porse i kërkohet atij që zemra t’i qëndrojë e palëkundur me Iman (Besim). Por, në rast se zemra e tij qëndron në anën e kufrit, mosbesimit, atëherë ai ka mohuar. Pra, janë katër raste:

Rasti i Parë: kur personi e bën qëllimisht

Rasti i Dytë: kur personi e bën për t’u tallur ose për t’i bërë të tjerët të qeshin

Rasti i Tretë: kur personi e bën nga frika

Rasti i Katërt: kur personi e bën atë nga detyrimi ndërkohë që zemra e tij është në kufër. Në këto katër raste personi ka bërë kufër.

Rasti i Pestë: është kur personi e bën nga detyrimi ndërkohë që zemra e tij qëndron mbi Iman. Ky person nuk bën kufër, për shkak të asaj çfarë thotë Allahu:

“Kushdo që bën kufër në Allahun, pasi që ka besuar, përveç atij që është detyruar dhe zemra e të cilit është e qetë me Besim, por sa për ata që i hapin gjokset e tyre kufrit (mosbesimit), mu mbi këta është Zemërimi i Allahut dhe për ta do të jetë dënimi i madh.” [Nahl, 106]

Dhe Allahu e di më së miri. Salati dhe selami qofshin mbi profetin tonë Muhamed, mbi Familjen dhe mbi Shokët e tij.

- Pyetjet dhe Përgjigjet pas Mësimit

Pyetje: Çfarë gjykimi ka mbajtja e konferencave dhe pjesëmarrja në to, të cilat thërrasin për unifikimin e feve?

Përgjigje: Nëse këta njerëz besojnë se këto fe janë të vërteta ose që pasuesit e tyre janë mbi të vërtetën, atëherë ky është kufër dhe dalje nga Feja, Allahu na ruajt. Kushdo që thërret për unifikimin e feve, për arsye se ai mendon se ato janë të sakta ose sepse ato janë të vërteta, atëherë ky person është mosbesimtar, sepse ai nuk i refuzon *tagutët*. Ky person që thërret për unifikimin e feve, nuk e refuzon *tagutin*. Ai po i thërret Muslimanët që të afrohen me fetë e Çifutëve dhe të Krishterëve, ose të jenë si ata, ose të pajtohen me ta, ose që ata janë mbi të vërtetën. Ky person nuk e ka mohuar *tagutin* – kjo është dalje nga Feja. Ky person ka kryer një nga ato gjëra që e hedhin poshtë Islamin.

Pyetje: Në lidhje me gjykimin për *tekfir*, kushdo që nuk i konsideron mushrikët mosbesimtarë, siç është, për shembull, Ibn Sina (Avicena), një person vjen e thotë: “Unë nuk e konsideroj mosbesimtar Ibn Sinën, për mua ai është Musliman.” A ka bërë kufër ky njeri?

Përgjigje: Nëse ai është në konfuzion rreth tij dhe nuk është në dijeni për gjendjen e tij, ai nuk bën kufër, derisa t’i bëhet e qartë çështja e tij (Ibn Sinës). Megjithatë, ai që e di që ai është mosbesimtar dhe se ai është ateist, porse prapë nuk e konsideron atë mosbesimtar, ky person bie tek një nga Anuluesit e Islamit. Por, kjo çështje nuk iu është bërë e qartë disa njerëzve, kështu që duhet të sqarohet çështja e tij për atë që nuk është në dijeni për gjendjen e tij.

Pyetje: [Vazhdon] Po nëse ai refuzon dhe thotë: “Mua nuk më kërkohet që ta bëj këtë.”

Përgjigje: Atij i kërkohet që ta bëj këtë. Kjo do të thotë se ai ka rënë në një nga këta Anulues të Islamit: **“Kushdo që nuk i konsideron mushrikët mosbesimtarë ose ka dyshime për kufrin, mosbesimin e tyre, ose i konsideron rrugët dhe besimet e tyre si të sakta, ka mohuar (ka bërë kufër).”**

Juve u kërkohet që t’i konsideroni mushrikët si mosbesimtarë, t’i armiqësoni dhe t’i urreni ata për hir të Allahut. Allahu u ka urdhëruar juve për këtë. Allahu e ka bërë Teuhidin urdhër për ju. Dhe nuk ka Teuhid, përveç kur robi t’i konsiderojë mushrikët

mosbesimtarë. Kushdo që nuk i konsideron mushrikët mosbesimtarë apo ka dyshime rreth mosbesimit të tyre, ose i konsideron të sakta rrugët dhe besimet e tyre, ky person është mosbesimtar si ata sepse ai nuk e refuzon *tagutin*. Kushdo që nuk e mohon dhe nuk e refuzon *tagutin*, nuk e ka besuar Allahun. Besimi dhe Teuhidi i tij në Allahun nuk është i saktë, derisa të jenë dy gjëra: (1) Refuzimi i feve dhe zotave të kotë (*Tagutit*), dhe (2) Besimi në Allahun. Refuzimi i i feve dhe zotave të kotë (*Tagutit*) është ajo me çfarë filloi Allahu në fillim me fjalën ***La ilahe il-lAllah*** (Nuk ka të adhuruar që meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut). ***La ilahe*** (Nuk ka të adhuruar që meriton të adhurohet me të drejtë) është refuzimi i feve dhe zotave të kotë.

Pyetje: Çfarë gjykimi ka për atë që nuk e konsideron një person si mosbesimtar, për shkak të dallimit në opinionin se a është ai mosbesimtar apo jo?

Përgjigje: Ky person që është shpallur mosbesimtar duhet të jetë dikush që ka refuzuar diçka që njihet në Fe në mënyrë të domosdoshme si obligim apo si diçka që njihet në Fe në mënyrë të domosdoshme si ndalim. Kështu, për shembull, kushdo që refuzon obligimin e Namazit, ka bërë kufër, për shkak të *Ixhmasë* që thotë se Namazi është obligim. Nuk ka ndonjë që të thotë se Namazi nuk është obligim. E njëjta gjë është edhe me atë që refuzon ndalimin e zinasë apo kamatës, sepse këto janë çështje mbi të cilat Muslimanët kanë rënë në *Ixhma* që ato janë të ndaluara (haram). Megjithatë, për ato çështje në të cilat ka dallim opinionesh apo në të cilat ka paqartësi, nëse dikush i refuzon ato, ai nuk ka bërë kufër.

Kështu, për shembull, nëse ai refuzon ndalimin e pirjes së duhanit, ai nuk ka bërë kufër, sepse ka paqartësi në lidhje me këtë çështje. Kjo, për shkak se disa njerëz jashtë këtij vendit (Arabisë Saudite) kanë dhënë fetva se është e lejuar pirja e duhanit, edhe pse ky është një opinion i gabuar. Kështu që ky person nuk ka bërë kufër. E njëjta gjë është edhe me personin i cili e refuzon faktin se abdesi urdhërohet për atë që ha mish deveje, ai nuk bën kufër sepse ka dallim mes opinioneve në lidhje me këtë çështje.

Pyetje: A justifikohet Muslimani për shkak të injorancës?

Përgjigje: Njeriu nuk justifikohet me injorancë, nëse ai ishte i aftë që ta largonte këtë injorancë nga vetja e tij dhe të kërkonte dikë për ta pyetur. Dhe, gjithashtu (ai nuk justifikohet), në lidhje me një çështje e cila njihet në Fe si e domosdoshme. Dhe personi i tillë nuk duhet të jetë i paqartë – (si, për shembull, kur) një njeri merret me kamatë mes Muslimanëve. Kështu që, kur i thuhet atij se kjo është e ndaluar (haram) ai thotë: “Nuk e di, unë jam injorant.” Kjo është e papranueshme, sepse kjo është një çështje që është bërë e qartë për çdo njeri.

Sidoqoftë, nëse është që jeton në një komunitet që merret me kamatë, dhe shembulli i saj është i paqartë dhe i fshehtë për të, dhe thotë, për shembull, që askush nuk e pranon Islamin atje, pra jeton në Amerikë dhe njerëzit atje merren me kamatë, kështu që ai mendon se ajo është e lejuar, ky person ndoshta (do të justifikohet), për shkak të

inJORANCËS. Kështu që, kur ky person bëhet Musliman dhe vazhdon të merret me kamatë dhe thotë: “Nuk e di, unë jam inJORANT.” – po, ky person është e mundur të justifikohet, për shkak të inJORANCËS. Domethënë, nëse inJORANCA është në lidhje me çështje të cilat janë nuk të prera dhe janë të paqarta, ai është i justifikuar. Kurse, për ato çështje që janë të qarta tek të cilat nuk ka paqartësi, ai nuk është i justifikuar. Në çështjet e paqarta, për të cilat dikush mund të jetë inJORANT, siç është rasti i këtij individi, ka mundësi që ky person të jetë i justifikuar për shkak të inJORANCËS.

Kjo është si ajo historia që është transmetuar në dy koleksionet e Sahihëve për një burrë i cili e urdhëroi familjen e tij (kur ai të vdiste) t’ia digjinin trupin dhe ta shpërndanin hirin e tij në det dhe në tokë, duke thënë: **“Nëse Allahu është i aftë që të më gjejë, Ai do të më dënojë me një Dënim të rëndë.”** Ai e bëri këtë nga inJORANCA. Dhe ajo që e shtyu që ta bënte këtë ishte frika nga Allahu, kështu që Allahu e fali dhe pati mëshirë për të. Ai nuk e bëri me qëllim, duke menduar se ai nuk do të përfshihej nga Caktimi i Allahut. Ai as nuk e refuzoi ringjalljen dhe as nuk e mohoi Aftësinë e Allahut, megjithatë, ai mohoi përsosmërinë e detajeve të Aftësisë së Allahut, sepse kaq ishte kapaciteti i dijes së tij. Ai nuk e mohoi këtë nga arroganca dhe nga kokëfortësia, porse ai ishte inJORANT dhe ajo çfarë e bëri atë që të vepronte kështu ishte frika që kishte ai nga Allahu. Pra, ky është shembulli i një çështjeje të paqartë, meqë ka të bëjë me të.

Kurse, sa për çështjet e qarta, atëherë ajo çfarë është e papranueshme është kur: Një burrë jeton mes Muslimanëve, porse ende nuk falet. Kur këshillohet, ai thotë: “Nuk e di nëse Namazi është obligim, unë jam inJORANT.” Ky person nuk po i kushton vëmendje. Dhe, po ashtu, nëse ai thotë: “Nuk e di nëse alkooli është haram” ose “nëse zinaja është haram”. Ky person nuk hyn tek ata që janë të paqartë, sepse këto janë çështje të qarta.

Pyetje: Çfarë themi për atë i cili nuk bën dallim mes kufrit të madh dhe kufrit të vogël në çështjen e gjykimit me diçka tjetër veç asaj që ka shpallur Allahu?

Përgjigje: Si nuk bën dallim? Allahu ka bërë dallim. Tekstet (fetare) dëshmojnë për dallimin midis këtyre të dyjave, sepse personi është gjynahqar. Ai person i cili jep një gjykim në një nga çështjet e shumta, ai është gjynahqar dhe ai nuk e ka refuzuar gjykimin me Sheriat. Ai e konsideron atë obligim, megjithatë, ai është mundur nga epshet e tij dhe shejtani.

Pyetje: A bën që çdokush t’i zbatojë këto gjykime në mënyrë të pakufizuar (në lidhje me Gjykimin me diçka tjetër veç asaj që ka shpallur Allahu) apo duhet që kjo çështje t’u kthehet njerëzve përkatës të saj (domethënë dijetarëve)?

Përgjigje: Këto çështje duhet t’u kthehen dijetarëve, sepse ata janë të cilët do t’i studiojnë dhe do të mendojnë rreth tyre. Njerëzit e thjeshtë dhe studentët duhet t’u referohen dijetarëve për këtë çështje dhe nuk u takon atyre të japin gjykime për këto çështje, sepse ata nuk e kanë plotësuar periudhën kohore të studimeve të tyre. Kurse, sa për njerëzit e zakonshëm, atëherë ata nuk janë të kualifikuar për këtë. Sa për studentët (e dijes),

atëherë edhe ata, gjithashtu, duhet t'u referohen dijetarëve dhe të mos japin gjykime e të bëjnë tekfir duke u bazuar mbi epshe të kota. Ndoshta, personi mund të marrë pak dije, të mësojë Kur'anin përmendësh dhe kështu ai nis të japi gjykime duke bërë *tekfir* mbi njerëzit. Kjo nuk i takon atij, ai duhet t'ua lë dijetarëve, për arsye se ai mund të mendojë për diçka se është kufër kur në fakt ajo nuk është e tillë dhe kjo për shkak të dijes së tij të pakët, dritëshkurtësisë dhe ngutjes në dhënien e gjykimeve.

Pyetje: Po, kur njëri prej udhëheqësve të Muslimanëve e përkrah diçka që është mëkat, për shkak të disa arsyeve apo për shkak të një arsyeje specifike, pastaj vijnë disa njerëz dhe gjykojnë se përkrahja e tij për këto gjëra (që janë mëkat) tregon se ai i konsideron ato të lejuara?

Përgjigje: Kjo nuk është e saktë. Mos ky person ja ka nxjerrë nga zemra këtë besim që ai po i konsideron të lejuara? A mos u ka treguar ai se po i konsideron ato të lejuara? Përkrahja e diçkaje mund të ndodhë për disa arsye, madje edhe gjynahqarët e përkrahin njëri-tjetrin, por prapëseprapë kjo nuk do të thotë se ata janë mosbesimtarë. Për më tepër, këto gjëra që po i mbrojnë dhe po i përkrahin ata, mundet të kenë gjëra të lejuara dhe të ndaluara që janë përzier në to.

Pyetje: A është e kufizuar bërja e kufrit tek përgënjeshtrimi (*tekdhīb*, përgënjeshtrimi i të vërtetës) dhe pasja e një besimi të palëkundur (*Itikad*, domethënë, të kesh besim të palëkundur në *Batil*)?

Përgjigje: Kufri nuk kufizohet vetëm tek përgënjeshtrimi (*tekdhīb*). Kufri ndodh, për shkak të përgënjeshtimit, kur dikush e përgënjeshton Allahun apo e përgënjeshton Pejgamberin, ose, nëse dikush refuzon diçka që njihet në Fe si e domosdoshme, ai, gjithashtu, ka bërë kufër. Gjithashtu, mund të ndodhë edhe nga ndonjë vepër, si, për shembull, rasti kur dikush i përkulet një idhulli, edhe nëse ai nuk e beson atë. Nëse dikush shkel mbi *Mus'haf* (mbi Kur'an) me këmbët e tij, duke e bërë këtë qëllimisht, ai ka bërë kufër. Ose, nëse ai e ndyn *Mus'hafin* me pislleqe apo me urinë qëllimisht, ai ka bërë kufër. Po ashtu, kufri mund të ndodhë nëpërmjet fjalëve. Për shembull, nëse dikush e shan Allahun, apo shan Pejgamberin, apo e mallkon Fenë Islame, ose tallet me Allahun dhe me të Dërguarin e Tij, ai ka bërë kufër, bazuar mbi fjalët e tij. Gjithashtu, kufri mund të ndodhë me anë të dyshimeve. Nëse dikush ka ndonjë dyshim për Allahun, ose për melekët e Tij, ose për Librat e shpallur, ose për Pejgamberët, ose ka dyshime për Xhenetin dhe për Xhehenemin. Për shembull, ai thotë: "Nuk e di, nëse ka apo jo Xhenet" ose "...nëse ka apo jo Xhehenem?" Ai bën kufër, për shkak të këtij dyshimi dhe pasigurisë së tij.

Kufri mund të ndodhi për shkak të braktisjes (*i'rad*), le të themi, për shembull, nëse dikush e braktis Fenë duke mos e mësuar atë apo duke mos e adhuruar Allahun. Ai bën kufër, për shkak të kësaj braktisjeje. Kurse, sa për mendimin e Murr'xhiave se kufri ndodh vetëm për shkak të përgënjeshtimit, mohimit (*tekdhīb*), kjo nuk është e vërtetë (kjo është *Batil*).

Pyetje: E zëmë se një person ka një konflikt, kështu që ia parashtron çështjen e tij trupit gjykues dhe gjykatësi (fetar) aty jep një gjykim për një çështje. Prapëseprapë, ky person e urren gjykimin që dha ky gjykatës për atë çështje. Çfarë gjykimi ka për këtë?

Përgjigje: Nëse ai nuk e urren, për shkak se ai është gjykimi i Allahut, atëherë ky person e urren, për shkak të disa arsyeve që kanë të bëjnë me çështjet e kësaj dynjaje. Prandaj, ai nuk e urren për shkak se ai është gjykimi i Allahut. Kështu që ky person nuk bie në kufër. Megjithatë, atij i kërkohet që t'i nënshtrohet gjykimin të Allahut dhe të Pejgamberit të Tij, për aq kohë që ai e di se ky është një gjykim fetar. Ai duhet të jetë i kënaqur me të, edhe nëse ky gjykim mund të jetë kundër tij, sikurse thuhet edhe në hadith: **“Kushdo që ka dikë që është betuar në Allah në praninë e tij, atëherë le të jetë i kënaqur me të, dhe kushdo që nuk është i kënaqur me të, ai nuk është i kënaqur me Allahun.”** Pra, robi duhet që të jetë i kënaqur me gjykimin e Pejgamberit.

Nëse e di se ky është gjykimi ligjor ai është i detyruar që t'i përmbahet atij. Allahu thotë:

“Por jo, për Zotin tënd, ata nuk kanë Besim, derisa të të bëjnë gjykues në të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, dhe të mos gjejnë në vetët e tyre këmbëngulje kundra vendimit tënd, dhe të pranojnë me nënshtrim të plotë.” [en-Nisa: 65]

Dhe, nëse ai e urren këtë gjykim, sepse është gjykimi i Allahut dhe i Pejgamberit të Tij, dhe, në vend të këtij, do dhe admiron gjykimin e ligjeve të bëra nga njerëzit, kjo është dalje nga Islami. Allahu na ruajt. Ky person ka preferuar gjykimin e *tagutit* para gjykimin të Allahut dhe Pejgamberit të Tij.

Por, në rastin kur ai e urren gjykimin e *tagutit*, porse nuk është i kënaqur me gjykimin fetar, për shkak se është ofenduar apo ka humbur diçka të ngjashme nga çështjet e kësaj dynjaje, jo sepse ai e urren gjykimin e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij, ky person nuk bie në kufër.

Pyetje: Çfarë keni për të thënë për atë që thotë për thënien e Allahut:

“Thuaju: A me Allahun, me Ajetet e Tij dhe me të Dërguarin e Tij po talleni? Mos u shfajësoni, vërtet ju keni mohuar, pasi që besuat” [Teube, 65-66]

se kjo u shpall për hipokritët (Munafikët) dhe se thënia e Tij **“pasi që besuat”** ka për qëllim Imanin e jashtëm (domethënë, nuk ka për qëllim atë që është në zemër)?

Përgjigje: Kjo është në kundërshtim me atë që është e qartë nga ajeti. Ky keqinterpretim kërkon argument për këtë, sepse në ajet ka ardhur: **“Mos u shfajësoni, keni mohuar, pasi që besuat.”**

Pyetje: [Vazhdon] A mos do të thotë kjo se ai u shpall për Sahabët?

Përgjigje: Po, ai u shpall për një grup prej tyre gjatë betejës së Tebukut. Hipokritët ishin të niveleve të ndryshme. Disa prej tyre nuk kishin fare Iman, disa prej tyre kishin Iman,

porse ai ishte i dobët, dhe disa prej tyre kishin Iman, por ai largua dhe u zhduk nga ata. Pra, ata ishin të llojeve të ndryshme.

Pyetje: Çfarë gjykimi ka shkuarja tek magjistarët?

Përgjigje: Nuk lejohet shkuarja tek magjistarët apo tek falltarët, apo tek astrologët, dhe as nuk lejohet që të pyeten ata. Ka ardhur një kërcënim i ashpër në një nga tekstet e transmetuara, në lidhje me pyetjen e tyre. Profeti (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*) ka thënë: **“Kushdo që shkon tek një falltar dhe e pyet atë për diçka, nuk do t’i pranohet namazi për dyzetë ditë.”** Ndërsa, kur dikush shkon tek një falltar dhe beson tek ajo çfarë i tregon ai, ai ka mohuar atë që i është shpallur Muhamedit (*sal-lAllahu alejhi ue sel-lem*). Ai që tregon fatin (*Kahin*), është dikush që merr një vizion nga Xhini, nga i cili është informuar rreth disa çështjeve të *Gajbit* (të padukshme) që do të ndodhin në të ardhmen. Ky person quhet *Kahin* (treguesi i fatit). Magjistari (*Sahir*) është dikush që bënë kontratë me shejtanët dhe bën kufër duke bërë formula dhe substanca magjike, lidh nyje, dhe këndon fjalë dhe yshtje. Astrologu (*munexh-xhim*) është dikush që pretendon dije mbi *Gajbin* duke u bazuar në shikimin që u bën yjeve, dhe ai pretendon se ata (yjet) kanë ndikim mbi çështjet e tokës. Parashikuesi (*‘arraf*) është dikush që pretendon se ka dije mbi çështjet, duke e informuar një person fillimisht për diçka (që i ka humbur) se është vjedhur dhe vendin ku e ka humbur atë.

E njëjta gjë është edhe me atë që shkruan germa dhe simbole numerike (*Ebaxhadin*): - *ebxhed heuez hutij kelamen sa’fes karshat thekhad dadig* – këto janë shkronjat *Ebaxhed*, që i shkruajnë disa njerëz, të cilat i përdorin për të arritur dijen e çështjeve të fshehta. Kurse, ai i cili i shkruan për të mësuar prej tyre (d.m.th. prej shkronjave) dhe nuk i përdor për të arritur dijen mbi *Gajbin*, si, për shembull, t’i përdorë për të arritur dije mbi të vdekurin e kështu me radhë, atëherë ai nuk hyn në këtë aspekt.

E njëjta gjë është edhe për atë që hap librin dhe pret Xhinin ose me atë që lexon filxhan, ose lexon në pëllëmbën e tij. Në qoftë se të gjithë këta individë pretendojnë se e dinë *Gajbin*, atëherë ata që të gjithë janë mosbesimtarë. Megjithatë, metodat e tyre janë të ndryshme. Por, në qoftë se ata që të gjithë pretendojnë se e dinë *Gajbin*, atëherë ata janë mosbesimtarë. Pra, nëse dikush pretendon se e di *Gajbin* nëpërmjet fjalëve magjike, yshtjeve, lidhjes së nyjeve, ilaçeve dhe barnave, atëherë ai quhet magjistar (*Sahir*).

Dhe, nëse ai pretendon se e di çfarë do të ndodhë në të ardhmen, atëherë ai është falltar (*Kahin*). Dhe, nëse ai pretendon dijen e *Gajbit*, me anë të vështimit të yjeve, ai quhet astrolog (*Munexhim*). Dhe, nëse ai pretendon dijen duke e ditur se ku ndodhet gjëja me vlerë, që është vjedhur, dhe ku është humbur, ai quhet parashikues, profetizues (*‘Arraf*). Po ashtu, ata që hedhin gurë dhe shkruajnë në dhé, duke pretenduar se e dinë *Gajbin*, të gjithë këta njerëz janë mosbesimtarë, të gjithë këta janë astrologë (*Munexhimun*).

Pyetje: Dëshirojmë një shpjegim të detajuar për çështjen e kërkimit të ndihmës nga Xhini i mirë.

Përgjigje: Sa i përket kërkimin të ndihmës nga Xhini, Shejkhul-Islam (Ibn Tejmije) ka përmendur se kontakti që bën njeriu me Xhinin ndodh në tri raste:

E para: Kur ai e thërret atë për tek Allahu dhe e urdhëron atë për të mirën dhe e ndalon nga e keqja. Kjo duhet medoemos. Thirrja për tek Allahu, urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja kërkohej si nga njerëzit, ashtu edhe nga Xhinët. Por, kjo ndodh vetëm atëherë kur ta ketë caktuar Allahu. Pra, ai vetëm duhet t'u bëjë atyre *daue* (t'i ftojë në Islam), t'i urdhërojë për të mirë dhe t'i ndalojë ata nga e keqja, e të mos i tejkalojë këto. Kjo mund të ndodhë, kur mund të jenë disa Xhinë të mirë, që marrin pjesë në ndonjë mexhlis ku mund t'u flasin njerëzve. Por, kjo bëhet fjalë atëherë kur personi i fton ata në Islam dhe i urdhëron ata për të mirën. Kjo është e domosdoshme.

E dyta: Që dikush të kërkojë ndihmë prej tyre në çështje të cilat janë të lejuara, si, për shembull, kur dikush u kërkon ndihmë, me qëllim që të rregullojë makinën e tij, ose të rregullojë fermën e tij, ose që të ndërtojë shtëpinë e tij. Shejkhul-Islam Ibn Tejmije ka thënë: “Parimi bazë për këtë është se kjo gjë është e lejuar.”

Por, megjithatë, nuk është me vend që një njeri të kërkojë ndihmë nga Xhinët, qoftë edhe në çështje të lejuara, për arsye se ne nuk mund t'i shohim Xhinët dhe nuk e dimë se çfarë është e vërtetë dhe çfarë është gënjeshtër në fjalët e tyre. Gjithashtu, Xhinët kanë më pak logjikë sesa njerëzit, dhe ata janë të pandershëm, kështu që ata do ta shpien njeriun drejt një përfundimi jo të mirë, sepse Allahu thotë:

“O ju që besoni, nëse ndonjë keqbërës (*fasik*) ju vjen me ndonjë lajm, atëherë verifikojeni atë.” [Huxhurat, 6]

Ky ajet i referohet keqbërësit nga mesi i njerëzve, kurse Xhinët janë akoma më të këqij për këtë gjë.

Disa prej atyre që lexojnë (mbi njerëzit që i kanë kapur Xhinët) kërkojnë ndihmë (nga Xhinët) në këtë mënyrë. Disa prej tyre thonë: “Unë i flas një Xhini dhe i kërkoj atij këtë e këtë dhe ai më ka njoftuar për këtë e këtë. Dhe ai më ka njoftuar ku mund ta gjej magjinë.” E kështu vazhdojnë edhe për gjërat e tjera. Madje, disa prej tyre thonë se ata janë Muslimanë. U themi: Kush ju informoi? A e dini ju se si është puna e tij? A mund t'i besohet atij? Ky Xhin veç një *fasik* (keqbërës) është. Ai e ka sulmuar këtë njeri (duke e mbajtur atë nën kontroll), kështu që ai është *fasik*. Prandaj, ti nuk duhet t'i marrësh lajmet e tij dhe as të kërkojë ndihmë prej tij. Ti vetëm ftoje atë për tek Allahu ose lexoji atij (Kur'an), dhe kërkoji që të dalë jashtë nga ky Musliman dhe të mos e dëmtojë atë.

Kurse, sa për atë çfarë thonë disa njerëz: “Kërkova këtë e këtë nga ai dhe ai më njoftoi për këtë e këtë dhe për këtë e këtë magji” dhe ulet me të për orë të tëra, por, prapëseprapë, Xhini nuk i tregon atij veçse gënjeshtër, kështu që si mund t'i besojë ai fjalëve të tij? Dhe nga e di ai se ky është i saktë? Pastaj, ata, ndoshta, mund edhe ta shpien atë në një përfundim jo të mirë, madje edhe në çështje të cilat janë të ndaluara,

sepse ata do ta çojnë atë gradualisht në shkallë të ndryshme, derisa ta bëjnë që të bjerë në Shirk."²

2.Sh.p (Isma'il Alarkon): Shejkhu nuk e shpjegoi situatën e tretë. Ajo është atëherë kur njeriu mban kontakt me Xhinët në çështje që janë të ndaluara, siç është përmendur në pyetje-përgjigjen e mëparshme.

Pyetje: Çfarë gjykimi ka leximi dhe besimi i horoskopit?

Përgjigje: Nëse dikush pretendon se e di *Gajbin* (të Fshehtën) nga ato, atëherë ky është mosbesim dhe dalje nga feja. Ky është *tenxhijm* (parashikimi i të ardhmes duke u bazuar në astrologji).

Pyetje: Po nëse dikush beson në këto horoskopë?

Përgjigje: Nëse dikush beson në pretendimin e tyre, kinse e di *Gajbin*, atëherë ai është mosbesimtar, për shkak se ai ka mohuar thënien e Allahut:

“Thuaj: Askush në qiej e në tokë nuk e di *Gajbin*, përveç Allahut.” [Neml, 65]

Pyetje: Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që do ta shërojë magjinë me magji të ngjashme, dhe thotë: “Jam i detyruar që ta bëj këtë”?

Përgjigje: Shërimi i magjisë njihet si *Nushrah* midis dijetarëve. Mendimi i saktë tek dijetarët, të cilët e kanë verifikuar këtë çështje, është se shërimi i magjisë me magji ndahet në dy kategori:

E para: Shërimi i magjisë me magji sikurse ajo. Kjo është e ndaluar.

E dyta: Shërimi i magjisë me këndime (rukje), të cilat janë ligjëruara në Fe ose me mjekime të lejuara.

Kjo është e lejuar. Dikush mund të lexojë Ajetin Kursij ose *Mu'awidhetejn* (Suren Felek dhe Nas), ose ajetet në të cilat flitet për magjinë. Ose ai mund të thotë lutje që janë ligjëruar në Fe si për shembull: **“O Allah, Zot i njerëzimit. Largoma këtë dëm dhe më shëro. Ti je Shëruesi. Nuk ka shërim, përveç shërimit Tënd, shërim i cili nuk lë asnjë sëmundje”** dhe **“Me Emrin e Allahut po bëj rukje mbi ty, për çdo gjë që është e dëmshme për ty dhe për çdo person ziliqar ose nga syri i keq. Allahu të shëroftë.”**

Ose ai mund të përdorë mjekime të lejuara ose barna të mira. Nuk ka kurrfarë dëmi tek kjo. Ky është mendimi i saktë që kanë ata që kanë verifikuar këtë çështje. Për më tepër, ky është mendimi që ka pëlqyer Ibnul-Kajjim dhe ky është mendimi që ka pëlqyer Imami dhe *Muxhedidi*, Muhamed bin Abdil-Uehab, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij *Kitabut-Teuhid*, ku thotë: **“Kapitulli: Çfarë ka ardhur në lidhje me *Nushran*.”**

Prandaj, *Nushrah* ndahet në dy kategori: *Nushrah* që është e lejuar dhe *Nushrah* që është e ndaluar. *Nushrah* do të thotë të shëroshe dhe të largosh magjinë që i është bërë dikujt. Shërimi i tij me të tillë magji është e ndaluar, kurse shërimi i saj me rukje të ligjëruara dhe mjekime të pranuar, është e lejuar.

Pyetje: A konsiderohet ai se i ka besuar atyre nëse ai shkon tek ata, dhe thotë: “Kjo është urgjente?”

Përgjigje: Kjo nuk lejohet. Ai s’duhet ta bëjë këtë, bazuar në opinionin e dijetarëve që e kanë verifikuar këtë çështje. Ai nuk duhet të shkojë tek ndonjë magjistar. Kurse, të besuarit e tyre është diçka krejt e ndryshme. Nëse ai u beson atyre, atëherë ai ka bërë kufër. Sidoqoftë, nuk lejohet të shkosh tek ata. Kjo është një rrugë e cila është e bllokuar (domethënë e ndaluar).

Pyetje: Si është puna me atë që i ndihmon mosbesimtarët kundër Muslimanëve nga frika për pronësitë e tij në këtë dynja?

Përgjigje: Ky person ka bërë kufër, edhe nëse e bën nga frika për pronësitë e tij në këtë dynja, duke u bazuar në tekstin e Kur'anit:

“Kjo, për shkak se ata parapëlqyen jetën e kësaj bote para asaj të Botës Tjetër.” [Nahl, 107]

Kjo do të thotë se ai zotëron disa prona të kësaj dynjaje. Ky person ka bërë kufër, sepse i ka dhënë përparësi pronave të kësaj dynjaje para Fesë së tij. Feja e Allahut ka përparësi para përfitimeve të kësaj dynjaje, nëse ai i vendos përfitimet e kësaj dynjaje para Fesë së tij, ai ka bërë kufër.

Pyetje: A janë të kufizuar Anuluesit e Islamit (domethënë a janë veç dhjetë)?

Përgjigje: Gjërat të cilat e mohojnë dhe e anulojnë Islamin e një personi janë të shumta. Dijetarët e çdo medhhebi - Hanbelitë, Shafi’itë, Malikitë dhe Hanefitë – kanë përfshirë në librat e tyre të *Fik’hut* kapituj të titulluar “Kapitulli: Gjykimi mbi *Murteadin*.” Kjo i referohet një personi i cili ka mohuar, pasi që ishte Musliman. Dhe ata kanë përmendur kategori të ndryshme të tyre (domethënë, kategori të ndryshme të braktisjes së Fesë). Hanefitë kanë përmendur më shumë gjëra që e anulojnë Islamin e dikujt nga të gjitha medhhebet e tjera. Në fakt, ata thonë: “Nëse dikush i referohet ndonjë xhamie apo *mus’hafit* si të vegjël, duke thënë *musejxhid* (xhami e vogël) apo *musejhif* (mus’haf i vogël), me qëllim që t’i poshtërojë ato, atëherë ai ka bërë kufër.”

Pyetje: Imami (Allahu e mëshiroftë) ka përmendur për disa nga këta Anulues të Islamit se ka *Ixhma* për ta mes dijetarëve, por ai nuk e ka përmendur këtë për të gjithë ata (Anuluesit).

Përgjigje: Dihet se për të gjithë Anuluesit ka *Ixhma*. Për këtë nuk ka asnjë dyshim. Ai vetëm ka përmendur *Ixhma* për disa prej tyre, me qëllim që t'i sqarojë. Të gjitha këto çështje njihen në Fe si të domosdoshme.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka “**largimi**” tek thënia e autorit: “**I dhjeti: Largimi nga Feja e Allahut duke mos e mësuar dhe duke e zbatuar atë...**”

Përgjigje: Kuptimi i **largimit** këtu është të larguarit nga Feja tërësisht, kështu që ai as nuk e mëson atë dhe as nuk vepron sipas saj.

[Fundi i Librit]